



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0529

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Zv.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahimimi, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE N.T.P.Gresa - Commerce , kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 632-24-1656-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, më 28.08.2024, mori këtë:

Vendim

- 1.Refuzohet, si e pabazuar ankesa e N.T.P.Gresa - Commerce me nr. 2024/0529 , e datës 20.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet”, me numër të prokurimit 632-24-1656-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës.
- 2.Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
- 3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankesues bazuar në nenin 31 par.5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.02.2024 Komuna e Gjakovës., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 632-24-1656-1-2-1.

Ndërsa me datën 31.05.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE N.T.P. Gresa - Commerce .

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizimë, vlera e parashikuar e kontratës: 121,600.00 euro.

Me 05.06.2024, OE N.T.P. Gresa - Commerce ., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 10.06.2024.

Me 20.06.2024, OE N.T.P. Gresa - Commerce ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2024/0529, duke e atakuar Njoftimin mbi Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 632-24-1656-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.P. Gresa - Commerce janë parashtruar si në vijim:

Pretendonim se Autoriteti i Prokurimit ka përdorur standarde të ndryshme gjatë vlerësimit të ofertave, duke kërkuar sqarime shtesë nga OE "DHF Company SH.P.K." për kontratën, ndërsa për ne nuk kërkoj asnjë sqarim për kontratat e punëtorëve. Arsyeja e eliminimit tonë u argumentua si abstrakte dhe pa detaje specifike, në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Kosovës.

Pohuam se OE "DHF Company SH.P.K." nuk plotësoi kriteret e dosjes së tenderit, duke mos ofruar dokumentacionin e nevojshëm për të dëshmuar përvojën e suksesshme në kontrata të ngjashme, dhe besojmë se kontratat dhe referencat e prezantuara ishin fiktive dhe jo të realizuara në të vërtetë.

Ne pranuan refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim pa marrë një arsyetim konkret, dhe kërkuam që OSHP të shqyrtojë nëse Autoriteti i Prokurimit ka vepruar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik të Kosovës. Argumentuam se ne kemi përmbushur të gjitha kriteret dhe kushtet për të qenë pjesë e tenderit dhe se diskriminimi ndaj nesh ishte kundër ligjit.

Ne kërkojmë që OSHP të shqyrtojë pretendimet tona dhe të nxjerrë një vendim bazuar në faktet dhe dokumentet e paraqitura, duke u përpjekur të evitojmë diskriminimin dhe të trajtohem në mënyrë të barabartë sipas ligjit në procedurat e prokurimit publik.

Duke u referuar kërkesave si më sipër N.T.P.Gresa - Commerce konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1, 7, 59, 60, 69 dhe 72 LPP-së.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Autoriteti kontraktues ka gjithashtu refuzuar pretendimin se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, duke argumentuar se operatori ka prezantuar kontrata për furnizim me pelet të cilat mbulojnë kërkesat në Fletoren e Detajeve Teknike (FDT), dhe ka ofruar sqarime për faturat dhe transaksionet bankare në përputhje me kërkesat e nenit 72 të LPP-së.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 05.07.2024, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa të aprovohet si e pa bazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli konstatoi paraprakisht se Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Ankuesi nuk është pajtuar me raportin e cituar përderisa AK është pajtuar me raportin e ekspertit. Krahas kësaj konstatohet se palët janë të informuara reciprokisht lidhur me shkresat kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.T.P.Gresa - Commerce eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0529 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se Operatori Ekonomik (OE) ankues ka paraqitur ankesë në Organin për Shqyrtimin e Prokurimeve Publike (OSHP) për mosrespektimin e dispozitave të nenit 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Autoriteti kontraktues i ka njoftuar OE ankues se është eliminuar nga procesi i prokurimit për shkak të mungesës së dëshmive për të përmbushur kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional, si dhe për mungesën e dokumentacionit të nevojshëm, si kontratat e punëtorëve dhe librezat e qarkullimit për pajisjet.

Eksperti shqyrtues ka konstatuar se OE ankues nuk ka plotësuar asnjërin nga kriteret e parashtruara në dosjen e tenderit, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dokumentacion të plotë për të cilin Autoriteti kontraktues ka kërkuar konfirmime dhe verifikime për përputhshmërinë e kontratave me operatore ekonomik privat.

OE ankues ka gjithashtu bërë pretendime lidhur me operatoret ekonomikë të tjerë pjesëmarrës, duke i akuzuar ata për papërgjegjshmëri, por eksperti shqyrtues ka konstatuar se oferta e OE "DHF Company SH.P.K." ka çmim më të ulët dhe është e përputhur me kërkesat e dosjes së tenderit.

Pra, pretendimet e OE ankues për shkelje të dispozitave të LPP-së nuk janë vërtetuar, pasi ky operator nuk ka dorëzuar dëshmi për të përmbushur kriteret e nevojshme, në dallim nga OE i rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues mbështetur në nenin 104 të LPP-së përveç që ka egzaminuar oferten e të rekomanduar për kontratë, ka egzaminuar, edhe oferten e parashtruesit të ankuesit dhe konsaton që në oferte mungojnë dëshmitë e kërkuara dokumentuara lidhur me III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, Lista e kontratave të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve, Ka ofruar list të kontratës por nuk ka përshkruar datën e përfundimit si dhe nuk ka ofruar referenca ose certifikata, tek paisjet nuk ka ofruar dëshmi librezat e automjeteve, si dhe kontratat e punës për se paku 06 punëtorë të kërkuar. Në rast se AK-ja përmes sqarimeve të kërkuara do të kishte vepruar sikurse me OE rekomandues për kontratë, prap OE ankues ka ofruar çmimin më të lartë ku kriter ka qen tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkruesat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit, sqarimet e ofruara gjatë procedurës t si dhe

nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues mbështetur në nenin 104 të LPP-së përveç që ka egzaminuar ofertën e të rekomanduar për kontratë, ka egzaminuar, edhe ofertën e parashtruesit të ankuesit dhe konsaton që në oferte mungojnë deshmimet e kerkuara dokumentuara lidhur me III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, Lista e kontratave të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listën të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve, OE ankues ka ofruar listë të kontratave por nuk ka përkrahur datën e përfundimit si dhe nuk ka ofruar referenca ose certifikata, tek paisjet nuk ka ofruar deshmimet e automjeteve, si dhe kontratat e punës për se paku 06 puntorë të kerkuar. Në rast se AK-ja do të kishte aplikuar nenin 72 të LPP-së përmes sqarimeve të kerkuara do të kishte vepruar sikurse me OE rekomandues për kontratë, prap OE ankues ka ofruar çmimin më të lartë ku kriter ka qen tenderi i pergjegjshem me çmimin më të ulët.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 632-24-1656-1-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administratë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - N.T.P."GRESA - COMMERCE "**
- Arkivës së OSHP-së: